

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin Bajram Miftari, duke vendosur në çështjen juridike sipas padisë së paditësit Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në P. të cilën e përfaqëson sipas autorizimit L. B., kundër të paditurit N.T.P “Sh. - 2 – MA”, me seli në P., për shkak të kompensimit të borxhit, nga baza e kontratës për garancinë, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 03.11.2016 me datën, 04.11.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I Miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimeve “S.”, me seli në P., ashtu qe detyrohet i padituri N.T.P “Sh. - 2 – MA”, me seli në P., që në emër të rimbursimit të borxhit, nga baza e kontratës për garancinë, paditësit t’ia paguaj shumën prej 10,000.00 €, me normën e kamatës siç e aplikojnë bankat e Kosovës, për mjetet e deponuara në bankë, pa destinim të caktuar, në afatin prej një viti, duke llogaritur nga paraqitja e padisë në gjykatë, dt. 01.10.2014, e deri në pagimin definitiv, brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

II Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Rrethanat procedurale të çështje

Paditësi K.S “S.” me datën 01.10.2014, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurit N.T.P “Sh.” - 2 - MA, për kompensim borxhi nga baza e kontratës së sigurimit. Në padi ka theksuar se i padituri kishte lidhur kontratë me përfituesin (QKUK-në), nga e cila i padituri ka qenë i detyruar që ta furnizoj me artikuj ushqimor përfituesin, ndërsa përfituesi ka marrë detyrim pagimin e çmimit në emër të mallrave të pranuar. Më tej ka theksuar se me të paditurin ka lidhur kontratë garancie me të cilën ka garantuar se në rast se i padituri nuk i përmbushë detyrimet ndaj përfituesit (QKUK-së), atëherë paditësi si sigures i garancisë do të përmbushë detyrimin deri në shumën e garantuar. Po ashtu, ka theksuar se i padituri nuk e ka respektuar kontratën për furnizimim me mallra, ndaj shfrytëzuesit (QKUK), dhe rrjedhimisht përfituesi e ka ndërprerë kontratën. Pastaj, paditësi duke u bazuar me kontratën e garancionit ia ka kompensuar dëmit përfituesit, duke kryer pagesa në dobi të tij në shumën prej 10,000.00€. Ka shtuar se disa herë i është drejtuar të paditurit për rimbursimin e borxhit në emër të pagesave të bëra nga kontrata për garancinë, por i padituri nuk i është përgjigjur, duke pretenduar se kjo drejtë nuk i njihet paditësit. I ka propozuar gjykatës që me aktgjykim ta detyrojë të paditurin që në emër të regresit t’ia paguaj shumën prej 10,000.00 €.

I padituri, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, ka deklaruar se shfrytëzuesi nuk i ka përmbushë detyrimet ndaj të paditurit sa i përket kontratës për furnizimin me mallra. Ka shtuar se me nenin 26.5 të Kontratës janë të përcaktuar modalitetet e pagesave nga ana e shfrytëzuesit. Po ashtu ka shtuar se pasi që shfrytëzuesi nuk i ka respektuar dispozitat e kontratës sa i përket pagesave,

i padituri nuk ka pasur mundësi që ta furnizoj me mallra. I ka propozuar gjykatës që me aktgjykim ta refuzojë kërkesëpadinë si të pa bazuar.

Gjykata, e ka ftuar të paditurin për pjesëmarrje në seanca përmes ftesave të rregullta. Edhe përkundër se i padituri ftesat për pjesëmarrje në seancë i ka pranuar, i njëjti nuk është paraqitur dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Rrjedhimisht gjykata shqyrtimet gjyqësore i ka mbajtur në mungesë të të paditurit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 423 pika 4 e LPK-së.

Paditësi, gjatë rrjedhës së shqyrtimeve gjyqësore ka deklaruar duke u bazuar në kontratën për garancionin e ka përmbushë detyrimin ndaj shfrytëzuesit, në shumën prej 10,000.00 €. Ka shtuar se duke u bazuar në faktin se e ka përmbushë detyrimin e marrë me kontratën për furnizimin me mallra ndaj përfituesit, i takon e drejta në kompensimin e asaj shume nga i padituri. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke u bazuar në provat e administruara, është vërtetuar baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë. I ka propozuar gjykatës që me aktgjykim ta detyrojë të paditurin, që paditësit t'ia paguaj shumën prej 10,000.00 €.

Gjendja faktike e konstatuar

Për të vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të plotë gjendjen faktike gjykata ka bërë administrimin e provave të lëndës, përmes leximit të tyre, si në vijim: certifikata e sigurimit për garancionin e kontratave e datës 23.06.2011; kërkesa për rimbursim e datës 22.12.2010; deklarata e garancionit e datës 22.06.2010; fletë dërgesat; urdhërpagesa e datës 16.12.2010; shkresa e QKUK-së, e datës 27.08.2010; vërejtja për mospërmbushjen e kontratës e datës 27.08.2010; kontrata për furnizimin me artikuj e lidhur në mes të të paditurit dhe përfituesit e datës 23.06.2010; forma propozuese për sigurim garancioni e datës 23.06.2010; urdhërpagesa e datës 16.12.2010; njoftimi i QKUK-së, i datës 30.08.2010; shkresa e QKUK-së, e datës 21.09.2010; njoftimi për shkëputjen e kontratës i datës 15.09.2009; reklamacioni për furnizim i datës 16.08.2010; kundërshtimi – sqarimi lidhur me ekzekutimin e garancionit, i paraqitur nga i padituri me datën 27.10.2010; dëshmia e QKUK-së, lidhur me pagesën e sigurimit të ekzekutimit të garancionit, prej 10,000.00 €, e datës 12.10.2010.

Pas administrimit të provave dhe vlersimit me kujdes të tyre, secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, dhe konstatimit të fakteve jo kontestuese, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- I padituri dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës (në tekstin e mëtejme QKUK), me datën 23.06.2010, kanë lidhur kontratë për furnizimin me mallra ushqimore. Nga kjo kontratë i padituri ka marrë detyrim që ta furnizoj me mallra ushqimore QKUK-në, ndërsa ajo ka marrë detyrim që në emër të mallrave të pranuar të kryej pagesat në emër të mallit të pranuar.
- Nga polica e sigurimit të garancionit, e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit, me datën 23.06.2011, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka marrë detyrimin që të paguaj shumën deri në 10.000 €, ndaj QKUK-së, në rast se ai parashtron kërkesën për atë pagesë garancioni. Pagesa do të bëhet nga paditësi deri në shumën prej 10,000.00 €, me kërkesën e parë të përfituesit dhe pa paraqitur asnjë kundërshtim apo ankesë, dhe në një afat sa më të shkurtër.

- Nga shkresa zyrtare e datës 12.10.2010, gjykata ka konstatuar se QKUK-ja i është drejtuar paditësit ku e ka njoftuar se e ka shkëputur kontratën me të paditurin. Po ashtu ka kërkuar që paditësi të kryej pagesën e shumës prej 10.000.00 €, në emër të kontratës së garancionit.
- Nga urdhërpagesa e datës 16.12.2010 dhe nga fatura e datës 22.12.2010, gjykata ka vërtetuar se paditësi në emër të kontratës së garancionit, në dobi të përfituesit ka bërë pagesë në garancionit, në shumën prej 10,000.00 €.

Baza juridike e kërkesëpadisë

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më sipër në këtë aktgjykim, gjykata shqyrtoi edhe bazueshmërinë e kërkesëpadisë. Kontrata e garancionit bankar është e rregulluar në dispozitat e nenit 1083-1087 të LMD-së. Konform detyrimeve të marra me kontratë dhe me dispozitat e nenit 1083, lidhur me nenin 1087.1 të LMD-së, paditësi ka qenë i detyruar t'ia transferoj shumën e sigurimit prej 10.000 €, shfrytëzuesit të sigurimit, QKUK. Pra, transferi në fjalë ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore dhe kontraktuese.

Me vet faktin se i padituri nuk ia ka kompensuar paditësit shumën e paguar prej 10.000 €, rrjedh se i padituri e ka shkelur Kontratën e Garancionit, ku është përcaktuar detyrimi i tij që të përmbush shumën e paguar në emër të garancionit. Po ashtu, i padituri ka shkelë edhe dispozitat e nenit 1087.3 të LMD-së, ku është përcaktuar se ka për detyrë që të paguaj çdo shumë të paguar në emër të garancionit, në rastet kur garancioni përmban klauzolën “me thirrjen e parë”, e klauzola tjera të ngjashme.

Me dispozitat e nenit 17 të LMD-së, është përcaktuar se pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë të zbatojnë detyrimet e veta dhe janë përgjegjës për mospërmbushjen e tyre.

Objekt i veçantë i shqyrtimit ishin edhe pretendimet e të paditurit se i ka përmbushur detyrimet ndaj përfituesit në mënyrë të rregullt, gjegjësisht e ka furnizuar në mënyrë të rregullt me mallra ushqimore. Shfrytëzuesi nuk i ka respektuar kushtet e kontratës sa i përket pagesave, dhe si rezultat i padituri nuk ka pasur mundësi që të bëjë furnizimin e rregullt me mallra ushqimore. Mirëpo, gjykata nuk i ka marrë për bazë këto pretendime sepse në rastet kur palët kontraktojnë sigurimin e ekzekutimit të kontratës, përkatësisht pagesën e garancionit “me thirrjen e parë”, apo me “kërkesën e parë” siç janë shprehur palët në kontratën e tyre, nuk është relevante se a i ka përmbush i padituri detyrimet kontraktuese ndaj QKUK-së, apo jo. Kërkesa e saj e parë, e ka detyruar siguruesin – në këtë rast paditësin, për pagesën e shumës së kërkuar të garancionit, prej 10.000 €. Gjykata sqaron më tutje për të paditurin se pretendimet e tij se ka qenë në nivel të përmbushjes së detyrimeve kontraktuese, mund të sqarohen nga i padituri me QKUK-në, si përfitueses e mjeteve prej 10.000 €, qoftë me mjete alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, qoftë në procedurë gjyqësore.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër dhe në dispozitat ligjore e kontraktuese të cituara më sipër, gjykata erdhi në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e miratoi në tërësi.

Gjykata e miratoi kërkesëpadinë edhe përkitazi me kumatën e vonesës së kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç borxhit kryesor, paditësit t'ia paguajë edhe kumatën ligjore siç e paguajnë

bankat në Kosovës, për deponimet prej një viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedh nga dita e ushtrimit të padisë, gjegjësisht data 01.10.2014, e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së.

Shpenzimet procedurale

Me nenin 463.1 të LPK-së, është përcaktuar se për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendos vetëm me kërkesë specifikuar të palës. Meqenëse në këtë çështje kontestimore, pala e paditur në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe nuk e ka bërë specifikimin e tyre, gjykata nuk vendosi për kompensimin eventual të tyre, por në pajtim me nenin 463.1 të LPK-së, vendosi që secila palë të bartë shpenzimet e veta.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
I.C.nr. 501/14, me datën 04.11.2016

Gjyqtari
Bajram Miftari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të tij.